

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ekzekutohet “Tani i Rruzhdit” në zemër të Sarandës, autorët me motor dhe skafandra e qëlluan sapo doli nga lokali! Hita takim urgjent me strukturat e policisë
ADRESA	https://versus.al/live-updates/-ne-sarande-44-vjecari-ekzekutohet-ne-mes-te-qytetit-nga-dy--i46846
BURIMI	versus.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 09:52:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 08:23:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f08e3b18f5ec8966409b6c93e5a35b781357dc4845e61b61bbae18b3def65e73
TEKSTI	2081ade18b3139ed43a661b465ba1d5f5247f22977d80d2691788565eeb64e57
PAMJA	fc80d923a695705558410debb3ccf7878f6557a2cce3f0df0f47157fcb8e3cb1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bf26e401faee038e1da7bd3a119b2237229a9fcd1596f3c1a86fbc622718d1aa
E MËPARSHMJA	56df287f843472a85b99b7d94a87634ff0d349df4d7de1369b9ca02f261580cd
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.


Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bf26e401faee038e1da7bd3a119b2237229a9fcd1596f3c1a86fbc622718d1aa>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[Ekzekutohet “Tani i Rruzhdit” në zemër të Sarandës, autorët me motor dhe skafandra e qëlluan sapo doli nga lokali! Hita takim urgjent me strukturat e policisë](#)

20 Shtator 2026, 10:23

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

—

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

-
-
-
-

Created and monetized by
[Live Updates](#) / 20 Shtator 2026, 10:23

Ekzekutohet “Tani i Rruzhdit” në zemër të Sarandës, autorët me motor dhe skafandra e qëlluan sapo doli nga lokali! Hita takim urgjent me strukturat e policisë

* Një atentat me armë zjarri ndodhi në qendër të Sarandës, pranë ish-Agjencisë së Vjetër. * Nga të shtënat humbi jetën 42-vjeçari Artan Myrtaj, ndërsa u plagos edhe një kalimtar. * Autorët dyshohet se ishin dy persona me skafandra, të cilët u larguan nga vendngjarja me motor *Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Skënder Hita ka mbërritur me urgjencë në Sarandë ku ka zhvilluar mbledhje me strukturat vendore të policisë



Shkruar nga Versus

Çfarë do të gjeni në brendësi

* Një atentat me armë zjarri ndodhi në qendër të Sarandës, pranë ish-Agjencisë së Vjetër. * Nga të shtënat humbi jetën 42-vjeçari Artan Myrtaj, ndërsa u plagos edhe një kalimtar. * Autorët dyshohet se ishin dy persona me skafandra, të cilët u larguan nga vendngjarja me motor *Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Skënder Hita ka mbërritur me urgjencë në Sarandë ku ka zhvilluar mbledhje me strukturat vendore të policisë

6 Postime
25 MINUTA ME PARE

VIDEO/ Ekzekutimi i 44-vjeçarit, Hita mbërrin me urgjencë në Sarandë. Takim me strukturat vendore të policisë



Pas ngjarjes së rëndë kriminale që tronditi Sarandën paraditen e kësaj të diele, ku 44-vjeçari Artan Murtaç u ekzekutua me armë zjarri, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Skënder Hita, ka mbërritur në Sarandë ku ka zhvilluar takime me strukturat vendore.

Takimi i Hitës me drejtuesit e Policisë në Sarandë vjen pas ngjarjeve të rënda kriminale që janë regjistruar muajt e fundit në qytetin bregdetar.

Policia ka ngritur pika kontrolli në aksin drejt Vlorës dhe Gjirokastrës, në përpjekje për të identifikuar dhe kapur autorët.

Ngjarja ka ndodhur në rrethana ende të paqarta, ndërsa nga të shtënat ka mbetur i plagosur edhe një kalimtar i rastësishëm. I plagosuri 73-vjeçar Xhevdet Skëndaj mori një plumb në shpinë teksa po kalonte rrugën.

Sipas të dhënave paraprake, dyshohet se në atentat kanë marrë pjesë dy persona, të cilët kanë lëvizur me motor dhe kanë mbajtur skafandra për të fshehur identitetin.

Hetimet vijnë për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe identifikimin e autorëve./Versus.al



6 ORE ME PARE

At*ntati në Sarandë, Artan Myrtaj tentoi të largohej sapo pikasi autorët (detaje nga ekzekutimi)





Pamje nga vendi i ngjarjes/Viktima Artan Myrtaj

Detaje të reja janë zbardhur nga atentati në qendër të Sarandës, ku u vra me armë zjarri 44-vjeçari Artan Myrtaj.


Sipas të dhënave paraprake, Myrtaj sapo ishte ulur për të pirë kafe në një lokal pranë kryqëzimit të ish-agjencisë, kur dy persona iu afruan nga rruga "Lefter Talo".

Mësohet se 44-vjeçari i ka pikasur autorët dhe ka tentuar të largohet me vrap në drejtim të rrugës "Vangjel Pandi". Dyshohet se të dy agresorët kanë hapur zjarr, duke e qëlluar të paktën dy herë.

Myrtaj mbeti i pajetë në mes të rrugës, ndërsa autorët u larguan menjëherë nga vendngjarja. Policia dhe grupi hetimor po punojnë për të rindërtuar dinamikën e plotë të atentatit, si dhe për identifikimin dhe kapjen e autorëve./Versus.al

6 ORE ME PARE

Vr*sja e 44-vjeçarit në Sarandë, reagon Policia: Plagoset një kalimtar, ngrihen pika kontrolli drejt Vlorës dhe Gjirokastrës



Policia ka reaguar zyrtarisht për atentatin e ndodhur mëngjesin e sotëm në qendër të Sarandës, ku mbeti i vrarë 44-vjeçari Artan Myrtaj dhe u plagos një kalimtar i rastit.

Ngjarja u regjistrua rreth orës 09:55, në zonën e njohur si ish-agjencia. Në rrethana ende të paqarta, ndaj Myrtajt është hapur zjarr, duke i shkaktuar vdekjen.

Nga të shtënat mbeti i plagosur edhe 73-vjeçari Xhevdet Skëndaj, i cili ndodhej rastësisht në vendngjarje. Ai u transportua në spital për të marrë ndihmë mjekësore.

Sipas të dhënave paraprake, autorët dyshohet se ishin dy persona me skafandra, të cilët lëviznin me motor. Pas sulmit ata u larguan me shpejtësi, ndërsa kjo dinamikë mbetet ende për t'u konfirmuar nga hetimet.

Policia është vënë në ndjekje të autorëve dhe ka ngritur pika kontrolli në drejtim të Vlorës dhe Gjirokastrës. Ndërkohë, grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë, po administron provat për zbardhjen e ngjarjes dhe identifikimin e personave të përfshirë.

Njoftimi i Policisë:

"Sarandë/Informacion paraprak

Rreth orës 09:55, te ish-agjencia, në rrethana ende të paqarta, është vrarë me armë zjarri shtetasi A. M., rreth 44 vjeç, si dhe ka mbetur i plagosur shtetasi Xh. S., rreth 73 vjeç, kalimtar i rastit, i cili është transportuar në spital për ndihmë mjekësore.

Shërbimet e Policisë janë vënë në ndjekje të autorëve. Janë ngritur pika kontrolli në drejtim të Vlorës dhe të Gjirokastrës.

Në vendngjarje ka shkuar grupi hetimor dhe, nën drejtimin e Prokurorisë, vijon puna për sqarimin e rrethanave, administrimin e çdo prove që i shërben hetimit, me qëllim identifikimin dhe kapjen e autorëve."/>

6 ORE ME PARE

I arrestuar në vitin 2025, u ekzekutua në mes të Sarandës, publikohet fotoja e 44-vjeçarit



Artan Myrtaj, i njohur edhe me nofkën “Tani Ruzhdiut”, është 44-vjeçari që u vra me armë zjarri në qendër të Sarandës.

Emri i tij rezulton i lidhur me hetimet për një ngjarje kriminale të ndodhur më 17 korrik 2025, në lagjen nr. 4 të qytetit, ku mbetën të plagosur me armë zjarri Ernest Lama dhe Gëzim Hajdaraj, të dy nga Kamza.

Sipas të dhënave të raportuara, autor i dyshuar i plagosjes ishte Ramadan Zoto. Artan Myrtaj, Klaus Jaçaj dhe Erjon Jaçaj dyshohej se e kishin ndihmuar atë të largohej pas ngjarjes.

Pas këtij episodi, në Sarandë u regjistruan disa ngjarje të tjera të rënda, të dyshuara si akte hakmarrjeje. Mes tyre ishte vrasja me eksploziv e Isuf Jaçajt, babait të Klaus Jaçajt, si dhe dëmtimi i pronës së Ramadan Zotos.

Autoritetet po hetojnë rrethanat dhe motivet e ekzekutimit të Artan Myrtajt, si dhe nëse vrasja e tij lidhet me konfliktet e mëparshme të regjistruara në qytetin bregdetar./Versus.al

7 ORE ME PARE

II akz*kutua në mes të rrugës në Sarandë kush është 42-vjeçari që u qëllua nga dy persona

© 2025 Kallimi në mjet të rregulluar në trafik, kuon komo 72 vjeçari qe u qenda nga dy persona me motor



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.